



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 47

2000

Dhjetor

P Ë R M B A J T J A

Ligj nr.8702 datë 1.12.2000	Për identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve dhe të fermave blegtorale	2059
Ligj nr.8710 datë 15.12.2000	Për disa ndryshime në ligjin nr. 8560, datë 22.12.1999, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”	2061
Ligj nr.8711 datë 15.12.2000	Për disa ndryshime në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”	2063
Ligj nr.8714 datë 15.12.2000	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”	2066
Ligj nr.8715 datë 15.12.2000	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8313, datë 26.3.1998 “Për tatimin mbi biznesin e vogël”	2068
Ligj nr.8716	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8437, datë	

datë 15.12.2000	28.12.1998, "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr.8507, datë 7.7.1999 dhe ligjin nr.8595, datë 6.4.2000	2070
Ligj nr.8717 datë 15.12.2000	Për vendosjen e pullave në artikujt e duhanit e të pijeve alkoolike	2072
Ligj nr.8719 datë 19.12.2000	Për një shtesë në ligjin nr.8449, datë 27.1.1999 "Kodi doganor i Republikës së Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr.8473, datë 14.4.1999	2074

L I G J
Nr.8702, datë 1.12.2000

**PËR IDENTIFIKIMIN DHE REGJISTRIMIN E KAFSHËVE DHE TË FERMAVE
BLEGTORALE**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

K U V E N D I

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:**

Neni 1

Qëllimi i këtij ligji është:

- a) disiplinimi i lëvizjes së kafshëve bujqësore nëpërmjet identifikimit individual;
- b) regjistrimi i fermave blegtorale dhe pajisja e tyre me numër të veçantë regjistrimi;
- c) shkëmbimi i shpejtë dhe i saktë i të dhënave për vendndodhjen e kafshëve për qëllime veterinarë, zooteknike dhe statistikore;
- ç) rregullimi i marrëdhënieve ndërmjet institucionit përgjegjës shtetëror dhe pronarëve të fermave blegtorale.

Neni 2

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

“Identifikim” është vendosja e numrave dallues individualë, sipas një kodi të përcaktuar.

“Kafshë për identifikim” janë speciet e kafshëve bujqësore të gjedhit, të buajve dhe të njëthundrakëve.

“Kartelë individuale” është certifikata me të dhënat individuale, gjenealogjike dhe veterinarë të kafshëve.

Neni 3

Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit organizon dhe kontrollon zbatimin e programit të identifikimit të kafshëve dhe regjistrimit të fermave blegtorale. Përgjegjës për realizimin dhe kontrollin e këtij programi janë shërbimi zooteknik dhe shërbimi veterinar në Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit.

Organet e qeverisjes vendore dhe ato të Ministrisë së Rendit Publik bashkëpunojnë me Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit për plotësimin e detyrave që rrjedhin nga ky ligj, sipas rregullave që përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 4

Shpenzimet për identifikimin e kafshëve dhe regjistrimin e fermave blegtorale mbulohen nga Buxheti i Shtetit, nga projekte dhe donatorë.

Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit përcakton radhën e identifikimit të kafshëve sipas specieve dhe shtrirjes në territor të regjistrimit të fermave.

Këshilli i Ministrave përcakton tarifat e shërbimeve për fermerët dhe autoritetin që do të mbajë Regjistrin Kombëtar të Identifikimit dhe Regjistrimit të Kafshëve dhe Fermave Blegtorale.

Neni 5

Pronari i gjedhëve, buajve dhe njëthundrakëve është i detyruar të kryejë matrikullimin e kafshëve në pronësi.

Nga pronari i fermës blegtorale mbahet regjistri i lëvizjes së blegtorisë, në të cilin përfshihen gjendja, lindjet, ngordhjet, therjet, blerjet dhe shitjet.

Identifikimi i fermave blegtorale bëhet nga shërbimi zooteknik dhe shërbimi veterinar në Drejtorinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit në rrethe. Për çdo lëvizje të kafshëve të identifikuara njoftohet autoriteti që mban Regjistrin Kombëtar të Identifikimit dhe Regjistrimit të Kafshëve dhe Fermave Blegtorale.

Lëvizja e kafshëve të identifikuara nga një pronar te tjetri, për prodhim, punë ose therje, shoqërohet me kartelën individuale që lëshohet nga ky autoritet.

Neni 6

Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit përcakton me rregullore:

- a) kodin e identifikimit i cili nuk duhet të kalojë 14 karaktere;
- b) modelin e matrikullit dhe përbërjen e tij;
- c) modelin e regjistrit të fermës dhe të kartelës përkatëse të kafshëve;
- ç) kohën më të përshatshme për regjistrimin e viçave të lindur;
- d) rregullat e identifikimit për kafshët e importuara;
- dh) numrin minimal të kafshëve për t'u quajtur fermë blegtorale;
- e) mënyrën e plotësimit dhe të lëvizjes së kartelës individuale.

Neni 7

Organet shtetërore të kontrollit janë: Inspektoriati Zooteknik, që funksionon në bazë të ligjit nr.7627, datë 21.10.1992 "Për shërbimin zooteknik" dhe Inspektoriati Veterinar, që funksionon në bazë të ligjit nr.7674, datë 23.2.1993 "Për shërbimin dhe inspektoriatin veterinar" në Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit.

Neni 8

Kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative shkeljet e mëposhtme:

- a) Kundërshtimi për identifikimin e kafshëve dhe mosrespektimi i kohës së caktuar për matrikullimin e të lindurve.
- b) Lëvizja e kafshëve për therje, pa njoftuar autoritetin kompetent.
- c) Lëvizja e kafshëve të identifikuara te pronarë të tjerë pa kartelën individuale.
- ç) Mospasqyrimi i lëvizjeve të njoftuara në Regjistrin Kombëtar të Identifikimit dhe Regjistrimit të Kafshëve dhe Fermave Blegtorale.

Neni 9

Për kundërvajtjet administrative të parashikuara në nenin 8 të këtij ligji nga organet e kontrollit jepen gjoba, si më poshtë:

- a) Për shkeljet e parashikuara në nenin 8 shkronja "a", "c" dhe "ç" nga Inspektoriati Zooteknik jepen gjoba nga 5 000 deri në 10 000 lekë.
- b) Për shkeljet e parashikuara në nenin 8 shkronja "b" nga Inspektoriati Veterinar jepen gjoba nga 3 000 deri në 5 000 lekë.

Neni 10

Procedurat e ankimit dhe të ekzekutimit të masës administrative bëhen në përputhje me ligjin nr.7697, datë 7.4.1993 "Për kundërvajtjet administrative".

Neni 11

Ngarkohen Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit të nxjerrin aktet nënligjore përkatëse në zbatim të neneve 3, 4 dhe 6 të këtij ligji.

Neni 12

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2827, datë 8.12.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

L I G J
Nr. 8710, datë 15.12.2000

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8560, DATË 22.12.1999 “PËR PROCEDURAT
TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I :

Në ligjin nr. 8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 36 shtohet një paragraf i ri me këtë përmbajtje:

“Organet tatimore rikarakterizojnë transaksionet edhe në rastin kur tatimpaguesit manipulojnë çmimet e shitjes. Në këtë rast ato marrin për bazë çmimet reale të tregut. Për mallrat e importuara, çmimet reale të tregut nisen nga çmimet e mallrave të marra parasysh nga organet doganore në çastin e zhdoganimit të mallrave, shpenzimet pas zhdoganimit dhe normën mesatare të fitimit për degën ose llojin e veprimtarisë. Këshilli i Ministrave cakton organet, të cilat llogarisin dhe publikojnë çmimet e tregut, si dhe llogarisin dhe publikojnë normën mesatare të fitimit për degën apo llojin e veprimtarisë.”

Neni 2

Pas nenit 36 shtohet neni 36/1 me këtë përmbajtje:

“Arkëtimet dhe pagesat

Për çdo transaksion shitblerjeje që e kalon vlerën 1 milion lekë, tatimpaguesit, që shesin dhe ata që blejnë, nuk mund të bëjnë arkëtime ose pagesa me lekë në dorë (cash). Në këtë rast ata janë të detyruar të veprojnë me kalime në llogari bankare.”

Neni 3

Pas nenit 36 shtohet neni 36/2 me këtë përmbajtje:

“Afishimi i çmimeve të shitjes

Tatimpaguesit, që kryejnë furnizime mallrash ose shërbimesh, janë të detyruar të afishojnë çmimin e shitjes së mallit që ata furnizojnë, ose të shërbimit që ata kryejnë, pavarësisht nga natyra e furnizimit dhe nga statusi i blerësit. Në rastin e shitjeve me shumicë, afishimi nënkupton pasqyrimin e çmimeve të shitjes në një listë të veçantë, e cila hartohet nga tatimpaguesi.”

Neni 4

Pas nenit 36 shtohet neni 36/3 me këtë përmbajtje:

“Shmangiet tatimore

Shmangie tatimore quhet çdo veprim i tatimpaguesit, i cili paraqet pamje të rreme të të dhënave të tij identifikuese, me qëllim shtrembërimin e të dhënave të domosdoshme për vlerësimin dhe përcaktimin e detyrimeve tatimore.”

Neni 5

Neni 42 shfuqizohet.

Neni 6

Neni 43 ndryshohet si vijon:

“Detyrimi për pagesë të menjëhershme

Para se të paraqiten për apelim, tatimpaguesit janë të detyruar të parapagujnë vetëm detyrimin tatimor, pa përfshirë interesat dhe gjokat e mundshme ose të paraqesin garancitë e nevojshme. Në rastin e garancisë, për periudhën e apelimit, llogariten të gjitha interesat.”

Neni 7

Pas nenit 52 shtohet neni 52/1 me këtë përmbajtje:

“Shkeljet dhe dënimet për kryerjen e arkëtimeve dhe të pagesave me lekë në dorë (në cash)

Kryerja me lekë në dorë e transaksioneve të shitblerjes, që e kalojnë vlerën 1 milion lekë, përbën shkelje si për shitësin, ashtu edhe për blerësin dhe dënohet me një gjobë të barabartë me 5 për qind të vlerës së transaksionit të kryer. Gjoka vendoset njëkohësisht si për shitësin, ashtu edhe për blerësin.”

Neni 8

Pas nenit 52 shtohet neni 52/2 me këtë përmbajtje:

“Shkeljet dhe dënimet për mosafishimin e çmimeve të shitjes

Mosafishimi i çmimeve të shitjes së mallrave ose i shërbimeve përbën shkelje dhe dënohet me gjobë 50 mijë lekë për tatimpaguesit e regjistruar në TVSH dhe me gjobë 10 mijë lekë për tatimpaguesit e biznesit të vogël.”

Neni 9

Në nenin 19 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Përfundimisht për vitet 2001, 2002 dhe 2003, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve i lihet 2 për qind e shumës vjetore të tatimeve të mbledhura, të cilat përdoren 70 për qind për investime dhe 30 për qind për shpërblime.”

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2847, datë 26.12.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

L I G J
Nr. 8711, datë 15.12.2000

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8438, DATË 28.12.1998
“PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT”

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I :

Në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 14 “Shkeljet” ndryshohet si vijon:

“Kundërvajtjet administrative.

Veprimet ose mosveprimet e mëposhtme sipas kreut II të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, janë kundërvajtje administrative:

a) Mosdokumentimi i pagesave të kryera, mosllogaritja dhe mosmbajtja e tatimit në burim, si dhe fshehja ose falsifikimi i të dhënave për të ardhurat e paguara për çdo tatimpagues.

b) Mosdeklarimi dhe mosderdhja në mënyrë korrekte e detyrimit për tatimin mbi të ardhurat personale nga individët që detyrohen të bëjnë një gjë të tillë, në zbatim të nenit 13 të këtij ligji.

c) Mosderdhja në buxhetin e shtetit nga agjentët tatimorë të tatimit të llogaritur.

ç) Mosmbajtja e regjistrimeve për të ardhurat e paguara tatimpaguesve dhe për tatimet e mbajtura, të cilat janë transferuar në buxhet, duke përfshirë mbajtjen e regjistrimeve për çdo tatimpagues.

d) Paraqitja me vonesë e deklaratës së të ardhurave personale, e kërkuar në zbatim të nenit 13 të këtij ligji.

dh) Mospagimi i detyrimeve tatimore në afatet e përcaktuara në këtë ligj.”

Neni 2

Neni 15 “Dënimet” ndryshohet si vijon:

“Kundërvajtjet administrative të parashikuara në nenin 14 të këtij ligji dënohen si vijon:

a) Për rastet e shkeljeve sipas shkronjave “a”, “b” dhe “c” të nenit 14, personat përgjegjës, përveç shumës së detyrimit të tatimit, paguajnë edhe një dënim të barabartë me shumën e këtij detyrimi tatimor.

b) Për rastet e shkeljeve sipas shkronjës “ç” të nenit 14, personat përgjegjës dënohen me gjobë

në masën 10 mijë lekë.

c) Për rastet e shkeljeve sipas shkronjës “d” të nenit 14, personat përgjegjës dënohen me gjobë në masën 20 mijë lekë.

ç) Për rastet e shkeljeve sipas shkronjës “dh” të nenit 14, personat përgjegjës paguajnë interesa për pagesë të vonuar në përputhje me ligjin nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Procedurat e ankimit dhe të ekzekutimit të masave administrative bëhen në përputhje me ligjin nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 3

Neni 28 “**Shkalla tatimore**” ndryshohet si vijon:

“Shkalla tatimore e tatimit mbi fitimin është 25 për qind.”

Neni 4

Në fund të paragrafit të parë të nenit 29 “**Deklarimi tatimor**” shtohen:

“Paraqitja e deklaratës vjetore e të ardhurave të tatueshme, e bilancit kontabël dhe e llogarisë së fitimeve dhe humbjeve nuk do të thotë miratim i të dhënave të tyre për qëllime fiskale nga ana e administratës tatimore edhe pse ato mund të jenë certifikuar nga ekspertë kontabël. Për qëllime fiskale të dhënat e këtyre dokumenteve konsiderohen të pranuar vetëm pasi ato të jenë kontrolluar nga ana e administratës tatimore.”

Neni 5

Neni 31 “Shkeljet” ndryshohet si vijon:

“Kundërvajtjet administrative.

Veprimet apo mosveprimet e mëposhtme, sipas Kreut III të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, janë kundërvajtje administrative:

a) Mospasqyrimi i saktë i të ardhurave dhe shpenzimeve nga veprimtaria me efekt në rezultatin financiar.

b) Falsifikimi i të dhënave dhe i dokumentacionit për të ardhurat dhe shpenzimet.

c) Mosparaqitja brenda afatit kohor e deklaratës tatimore dhe e bilancit kontabël së bashku me anekset e tij.

ç) Mosrespektimi i afatit të përcaktuar në këtë ligj për pagimin e tatimit.

d) Mbajtja e gabuar e llogarive, pa pasoja në rezultatin financiar.”

Neni 6

Neni 32 “**Dënimet**” ndryshohet si vijon:

“Kundërvajtjet administrative të parashikuara në nenin 31 të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, janë kundërvajtje administrative dhe dënohen si vijon:

a) Për rastet e shkeljeve sipas shkronjave “a” dhe “b” të nenit 31 të këtij ligji, personat përgjegjës, përveç shumës së detyrimit të tatimit, paguajnë edhe një dënim të barabartë me shumën e këtij detyrimi tatimor.

b) Për rastet e shkeljeve sipas shkronjës “c” të nenit 31 të këtij ligji, personat përgjegjës dënohen me gjobë në masën 40 mijë lekë.

c) Për rastet e shkeljeve sipas shkronjës “ç” të nenit 31 të këtij ligji, personat përgjegjës paguajnë interesa për pagesë të vonuar, në përputhje me ligjin nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

ç) Për rastet e shkeljeve sipas shkronjës “d” të nenit 31 të këtij ligji, personat përgjegjës dënohen me gjobë 10 mijë lekë.

Procedurat e ankimit dhe të ekzekutimit të masave administrative bëhen në përputhje me ligjin

nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.”

Neni 7

Paragrafi 6 i nenit 38 “**Dispozita Kalimtare**” ndryshohet si vijon:

“Tatimpaguesit, që kanë përfitur lehtësi tatimore në përputhje me nenin 6 të ligjit nr. 7677, datë 3.3.1993 “Për tatimin mbi fitimin”, i gëzojnë këto lehtësi sipas kushteve të parashikuara në ligjin e mësipërm.”

Neni 8

Pasqyra nr.1 që i bashkëlidhet ligjit ekzistues, zëvendësohet me pasqyrën nr. 1 që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

Shpallur me dekretin nr.2848, datë 26.12.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

PASQYRA NR. 1

E ARDHURA E TATUESHME MUJORE		TATIMI MBI TË ARDHURËN PERSONALE MUJORE	
MBI (Në lekë)	DERI (Në lekë)	Lekë	Përqindje
0	10 000		Pragu përjashtues
10 000 +	20 000	0	+ 5 % të shumës mbi 10 000
20 000 +	30 000	500	+ 10 % të shumës mbi 20 000
30 000 +	50 000	1 500	+ 15 % të shumës mbi 30 000
50 000 +	80 000	4 500	+20 % të shumës mbi 50 000
80 000 +	Më tepër	10 5000	+ 25 % të shumës mbi 80 000

L I G J

Nr. 8714, datë 15.12.2000

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7928, DATË 27.4.1995 “PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I :**

Në ligjin nr. 7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, ndryshuar me ligjet nr.

8070, datë 15.2.1996; nr. 8126, datë 9.7.1996; nr. 8130, datë 22.7.1996; nr. 8149, datë 11.9.1996; nr. 8160, datë 7.11.1996; nr. 8186, datë 23.1.1997; nr. 8201, datë 20.3.1997; nr. 8240, datë 16.9.1997; nr. 8445, datë 21.10.1999, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 26 pas paragrafit të dytë shtohet ky paragraf me këtë përmbajtje:

“Për makineritë dhe pajisjet që importohen për t’u investuar në fushën e prodhimit, të ndërtimit dhe të telekomunikacioneve, zbatohet sistemi i shtyrjes së pagesës së TVSH-së. Sipas këtij sistemi, TVSH-ja nuk paguhet në doganë në çastin e importit. Këshilli i Ministrave përcakton skemën e shtyrjes së pagesës.

Neni 2

Në nenin 50, pas pikës 3 shtohen pikat 4 dhe 5, me këtë përmbajtje:

“4. Eksportuesit kanë të drejtë të kërkojnë rimbursim kur teprica e tyre tejkalon shumën 400 000 (katërqind mijë) lekë.

Organet tatimore bëjnë rimbursimin e tepricës kreditore të TVSH-së për këtë kategori tatimpaguesish, brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës.

5. Këshilli i Ministrave përcakton kategorinë e eksportuesve të përmendur në pikën 4 të këtij neni”.

Neni 3

Neni 53 ndryshohet si vijon:

“a) Kur organet tatimore bëjnë një rimbursim të TVSH-së për një person, në bazë të nenit 52 ata paguajnë interesa për shumën e rimbursimit, sipas përqindjeve të përcaktuara në nenin 49, vetëm kur rimbursimet bëhen më vonë se një vit pas datës kur personi ka paguar TVSH-në, të cilat llogariten nga data kur vendimi gjyqësor ka marrë formën e prerë deri në datën e rimbursimit.

b) Kur organet tatimore nuk bëjnë rimbursimin e TVSH-së, të kërkuar nga tatimpaguesi në afatet e përcaktuara në nenin 50 të këtij ligji, ato paguajnë interesa për shumën e rimbursimit, sipas përqindjeve të përcaktuara në nenin 49”.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2849, datë 26.12.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**

L I G J

Nr.8715, datë 15.12.2000

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8313, DATË 26.3.1998 “PËR TATIMIN MBI BIZNESIN E VOGËL”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË V E N D O S I:

Në ligjin nr.8313, datë 26.3.1998 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 1 “Subjektet e tatimit të biznesit të vogël”, paragrafi i parë ndryshohet si vijon:

“Subjekt i tatimit mbi biznesin e vogël është çdo person që kryen biznes në territorin e Republikës së Shqipërisë gjatë çfarëdo periudhe të vitit kalendarik, i cili realizon një xhiro vjetore deri në 8 milionë lekë dhe që nuk i nënshtrohet tatimit mbi vlerën e shtuar.”

Neni 2

Neni 5 “Tarifa e tatimit” ndryshohet si vijon:

“Tatimi mbi xhiron për tatimpaguesit që realizojnë shumën nga 2 deri në 8 milionë lekë, për çdo vit kalendarik, është 4 për qind e xhiros.”

Neni 3

Neni 6 “Deklarimi” ndryshohet si vijon:

“Deklarimi me shkrim i xhiros nga tatimpaguesi, për shumën nga 2 deri në 8 milionë lekë në vit, bëhet deri më 28 shkurt të vitit pasardhës.

Gjatë vitit, organet tatimore detyrohen të vërtetojnë vëllimin e xhiros së realizuar. Për këtë, ato kanë parasysh të dhënat nga arkat regjistruese, kuponat tatimore, librat e blerjes dhe të xhiros, të dhënat nga doganat, nga degët e thesarit etj., si dhe të dhënat e rezultuara nga fotografimet, kronometrimet, sipërfaqet prodhuese ose të shërbimit që ka tatimpaguesi, pozicioni i vendit të biznesit etj.”

Neni 4

Neni 7 “Dokumentacioni dhe regjistrimet” ndryshohet si vijon:

“1. Tatimpaguesi detyrohet të mbajë librin e xhiros. Në këtë libër, tatimpaguesi regjistron xhiron e realizuar çdo ditë. Xhiroja e realizuar gjatë ditës është shuma e shitjeve të realizuara, nëpërmjet kuponave tatimorë ose dëftesave tatimore të lëshuara.

Tatimpaguesi detyrohet të mbajë librin e blerjeve. Në këtë libër, tatimpaguesi regjistron çdo ditë blerjet e bëra gjatë ditës. Shumat dhe blerjet ditore duhet të justifikohen me faturat tatimore të blerjeve (faturë e thjeshtë, e lëshuar nga tatimpaguesit e tjerë të biznesit të vogël ose faturë me TVSH, e lëshuar nga tatimpaguesit e regjistruar në TVSH). Librin e blerjeve nuk janë të detyruar ta mbajnë tatimpaguesit e pikave “Dh. Profesione”; “E.Ambulant, artizanat” dhe “Ë.Transport” të nenit 3 të ligjit nr.8313, datë 26.3.1998 “Për tatimin mbi biznesin e vogël”.

Libri i xhiros dhe libri i blerjeve sekretohen nga organi tatimor i rrethit përkatës.

2. Të gjithë tatimpaguesit e biznesit të vogël, të pajisur me arkë regjistruese, janë të detyruar të lëshojnë kuponin tatimor për çdo shitje të kryer.

Të gjithë tatimpaguesit e tjerë të biznesit të vogël, të cilët nuk janë të pajisur me arkë regjistruese ose megjithëse e kanë atë, por për shkaqe të parashikuara në ligj nuk e përdorin, janë të detyruar të lëshojnë dëftesë tatimore. Dëftesa tatimore lëshohet në çastin e furnizimit me mall ose të shërbimit të kryer dhe në rastet e parapagimit në çastin e marrjes së parapagesës.

Format e dëftesës tatimore përcaktohen nga Ministri i Financave.

3. Kuponat ose dëftesat tatimore të shitjes, faturat e blerjes, librat e xhiros dhe librat e blerjeve ruhen për një periudhë jo më pak se 5 vjet.

4. Tatimpaguesit e biznesit të vogël janë të detyruar të paraqesin të gjithë dokumentacionin e mësipërm, kur ai u kërkohet nga organet tatimore.

5. Tatimpaguesit janë të detyruar të afishojnë, në çdo rast, çmimin përfundimtar të mallit që shesin ose të shërbimit që kryejnë.

6. Tatimpaguesit janë të detyruar, për qëllime kontrolli, të lejojnë hyrjen e punonjësve të organeve tatimore në mjediset e biznesit.”

Neni 5

Neni 8 “Pagesa” pika 4 ndryshohet si vijon:

“4. Tatimi mbi xhiron, në masën 4 për qind, paguhet 2 herë në vit dhe, konkretisht, brenda muajit shtator paguhet kësti i parë dhe brenda muajit nëntor paguhet kësti i dytë.”

Neni 6

Neni 9 “Përgjegjësia dhe shkeljet” ndryshohet si vijon:

“1. Përbëjnë kundërvajtje administrative këto shkelje:

Mosregjistrimi sipas kërkesave të përcaktuara në Kreun II.

Mosplotësimi i deklaratës siç është përcaktuar në Kreun III.

Mosnjoftimi i organeve tatimore për ndryshimin në emrin, adresën, vendin dhe llojin e biznesit etj.

ç) Mosekspozimi i certifikatës së regjistrimit sipas pikës 9 të nenit 4 të ligjit nr.8313, datë 26.3.1998 “Për tatimin mbi biznesin e vogël”.

d) Mosparaqitja e certifikatës së regjistrimit nga tatimpaguesit ambulantë, kur ajo u kërkohet nga organi tatimor.

dh) Mospagimi i tatimit në afatet e caktuara.

e) Mosrespektimi i kërkesave të përcaktuara në pikën 1 të nenit 7 të ligjit nr.8313, datë 26.3.1998 “Për tatimin mbi biznesin e vogël”.

ë) Moslëshimi i kuponit ose i dëftesës tatimore ose lëshimi i tyre me vlerë më të vogël se vlera reale.

f) Mosrespektimi i kërkesave të përcaktuara në pikën 3 të nenit 7 të ligjit nr.8313, datë 26.3.1998 “Për tatimin mbi biznesin e vogël”.

g) Mosrespektimi i kërkesave të përcaktuara në pikën 4 të nenit 7 të ligjit nr.8313, datë 26.3.1998 “Për tatimin mbi biznesin e vogël”.

gj) Mosrespektimi i kërkesave të përcaktuara në pikën 5 të nenit 7 të ligjit nr.8313, datë 26.3.1998 “Për tatimin mbi biznesin e vogël”.

h) Mosrespektimi i kërkesave të përcaktuara në pikën 6 të nenit 7 të ligjit nr.8313, datë 26.3.1998 “Për tatimin mbi biznesin e vogël”.

2. Për shkeljet e mësipërme jepen këto dënime:

a) Shkeljet e përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 1 të këtij neni dënohen me gjobë në masën 20 mijë deri në 50 mijë lekë.

b) Shkeljet e përcaktuara në shkronjat “c”, “ç” dhe “d” të pikës 1 të këtij neni dënohen me gjobë në masën 20 mijë lekë.

c) Shkeljet e përcaktuara në shkronjën “dh” të pikës 1 të këtij neni dënohen me gjobë në masën 20 mijë lekë.

ç) Shkeljet e përcaktuara në shkronjat “e”, “ë”, “f” dhe “g” të pikës 1 të këtij neni dënohen me gjobë në masën 20 mijë lekë.

d) Shkeljet e përcaktuara në shkronjat “gj” dhe “h” të pikës 1 të këtij neni dënohen me gjobë në masën nga 10 mijë deri 20 mijë lekë.”

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2850, datë 26.12.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

L I G J

Nr.8716, datë 15.12.2000

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8437, DATË 28.12.1998, "PËR AKCIZAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8507, DATË

7.7.1999 DHE LIGJIN NR.8595, DATË 6.4.2000

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË V E N D O S I:

Në ligjin nr.8437, datë 28.12.1998 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr.8507, datë 7.7.1999 dhe ligjin nr.8595, datë 6.4.2000 bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 3 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

"Shkronja "A: Duhan e prodhime duhani" dhe shkronja "B: Pije alkoolike, alkoole" ndryshohen si vijon:

"Kapitulli	Kodi N.C	Përqindja e akcizës	Vlera e akcizës për një pullë
24	A. Duhan e prodhime duhani		
- 24.03	Duhan për konsum	60	
- 24.02	Cigare, kat.I dhe II		11 lekë/paketa
	kat.III		7 lekë/paketa
- 24.02.1000	Puro		2.240 lekë/kg
22	B. Pije alkoolike, alkoole		
- 22.03.00	Birrë	50	
- 22.04	Verë		
	- Me vlerë deri 300 lekë/litri		50 lekë/litri
	- Me vlerë mbi 300 lekë/litri		150 lekë/litri
- 22.08	Raki, konjak, uzo, vodka, fërnet, ponç, likerna, wiski, campari, rum, martini e të tjera pije alkoolike		
	- Me vlerë deri 400 lekë/litri		40 lekë/litri
	- Me vlerë mbi 400 lekë/litri		350 lekë/litri
- 22.07	Alkool etilik jo i denatruar i një force alkoolike ndaj volumit prej 80 % vol. ose më e lartë, alkool etilik dhe alkoole të tjera të denatruara, të çdo lloj force, për prodhim pijesh alkoolike		50 lekë/litri
- 22.08	Alkool etilik jo i denatruar i një force alkoolike ndaj volumit prej më pak se 80 % vol., për prodhim pijesh alkoolike		50 lekë/litri"

Pas paragrafit të fundit, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Personat juridikë a fizikë, vendas dhe të huaj, që importojnë alkool për prodhim pijesh alkoolike, do të deklarojnë në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve sasinë e alkoolit që do të importojnë, si dhe do të paraqesin dokumentin për pagesën e akcizës, sipas vlerës së përcaktuar në nenin 1 të këtij ligji."

Neni 2

Pas nenit 11 shtohet neni 11/1 me këtë përmbajtje:

"Nga sasia e pullave fiskale të tërhequra nga tatimpaguesi (prodhues dhe importues cigaresh), 0.5 për qind e saj pranohet si pullë fiskale e dëmtuar dhe hedhurinë.

Kjo sasi pullash fiskale, të dëmtuara brenda vitit kalendarik, do të zëvendësohet me pulla të reja fiskale dhe subjekti është i detyruar të paguajë vetëm vlerën e vetë pullës."

Neni 3

Pas nenit 11/1 shtohet neni 11/2 me këtë përmbajtje:

"Ministria e Financave dhe Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit përcaktojnë kategorinë për çdo lloj cigareje."

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2851, datë 26.12.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

L I G J **Nr. 8717, datë 15.12.2000**

PËR VENDOSJEN E PULLAVE NË ARTIKUJT E DUHANIT E TË PIJEVE ALKOOLIKE

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË V E N D O S I :

Neni 1

Artikujt e duhanit e të pijeve alkoolike që prodhohen, importohen, magazinohen ose hidhen në qarkullim në Republikën e Shqipërisë, pajisen detyrimisht me pullën fiskale të Ministrisë së Financave.

Neni 2

Pulla fiskale e Ministrisë së Financave është letër me vlerë dhe monopol i shtetit.

Neni 3

Për mallrat, të cilat detyrimisht duhet të jenë të pajisura me pullën fiskale të Ministrisë së Financave, kur organet shtetërore të autorizuar zbulojnë se gjatë importit, magazinimit ose kur ato janë hedhur në qarkullim, nuk janë të pajisura me pullën fiskale, bëjnë menjëherë konfiskimin e tyre dhe mbyllin vendin e biznesit për një periudhë kohe jo më pak se dy muaj.

Mallrat e konfiskuara rishiten nga organet përkatëse në ankand.

Organi shtetëror i autorizuar për shitjen e tyre është i detyruar t'i pajisë ato me pullë fiskale, e cila lëshohet nga Ministria e Financave dhe është e ndryshme nga pullat e zakonshme që tregojnë detyrimet fiskale.

Neni 4

Ngarkohet Ministri i Financave të nxjerrë aktet nënligjore për administrimin e pullave fiskale.

Neni 5

Rregullat për administrimin dhe shitjen e mallrave të konfiskuara në artikujt e duhanit dhe të pijeve alkoolike përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 6

Ligji nr. 8262, datë 15.12.1997 "Për vendosjen e pullave në artikujt e duhaneve e të pijeve alkoolike dhe për ngjyrosjen e nënprodukteve të naftës", si dhe çdo dispozitë tjetër ligjore që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2852, datë 26.12.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

L I G J

Nr.8719, datë19.12.2000

PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.8449, DATË 27.1.1999 "KODI DOGANOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8473, DATË 14.4.1999

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në pikën 4 të nenit 37 të ligjit nr.8449, datë 27.1.1999 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr.8473, datë 14.4.1999, shtohet shkronja "c" me këtë përmbajtje:

"c) Pagesat për të drejtën e pronësisë intelektuale (royalties) dhe për të drejtën e licencës (licence fee) për filmat kinematografikë të importuar në Republikën e Shqipërisë me të drejtën e

riprodhimit dhe të shpërndarjes, nuk do t'i shtohen çmimit realisht të paguar ose që duhet paguar.”

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2842, datë 23.12.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**

Fletorja Zyrtare gjendet në:

1. Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
2. Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare,
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 3.1.2001
Doli nga shtypi më 4.1.2001

Tirazhi: 3700 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Çmimi: 150 lekë